

Më shumë mbrojtje për shëndetin dhe pagat tona!

**Demonstrata e
madhe në Bernë
21 shtator 2013**



Mbrojtje për shëndetin tonë!

Rrobot mbrojtëse duhet t'i paguajë punëdhënësi!

Mbrojtja nga zbritja e pagave!

Pagat e shumë punëtorëve të ndërtimtarisë janë nën presion. Në nivelin e shefave përkundrazi ka pasur rritje enorme të pagave. Ne duam më shumë mbrojtje për pagat tona dhe të ndalojmë mashtruesit.

UNIA



«Në kantiere të ndërtimitarisë stresi është shtuar brutalisht. Ne duhet të ndërtojmë gjithnjë e më shpejtë e më shumë me më pak njerëz. Kështu shtohet edhe rreziku nga lëndimet. Ne na duhen rregulla më të ashpëra për mbrojtjen e shëndetit tonë.»

Jesus Quinta Gerpe, punëtor ndërtimtarie, Londrino, Tesinë



«Tek ne në Nojshatel deri më tani një pjesë e ndërmarrjeve të ndërtimitarisë i kanë paguar rrobat e punës. Ne, së bashku me Shoqatën regjionale të ndërtimtarëve, tani u kemi shkruar të gjitha ndërmarrjeve dhe e kemi bërë të qartë se: ndërmarrja duhet të paguaj rrobat e punës.»

Silvia Locatelli, sekretare e sindikatës, Nojshatel

Nuk duhet kursyer në sigurinë tonë!

Ndërtimtarët e Nojshatelit prijnë me shembull të mirë. Së bashku me Unia u kanë shkruar të gjitha ndërmarrjeve të ndërtimitarisë: «Rrobat mbrojtëse janë çështje e punëdhënësit!»

Nojshatelasit kanë të drejtë: mjetet mbrojtëse personale duhet të paguhen nga punëdhënësi. Por jo vetëm kaq: punëdhënësit obligohen edhe për mirëmbajtjen dhe pastrimin. Kështu thotë ligji! Në të vërtetë, shumë punëtorë të ndërtimitarisë duhet të paguajnë vetë për pastrimin e rrobave të punës apo duhet t'i blejnë vetë këpucët e punës. Prandaj ne duam tani t'i vëmë pikë kësaj pune dhe të sigurojmë që, pronarët do të sigurojnë dhe do të pastrojnë rrobat e punës. **Për sigurinë e punëtorëve të ndërtimitarisë nuk guxon të kursehet!**

Rrobat mbrojtëse janë çështje e punëdhënësit!



Ligji është i qartë

- Mjetet mbrojtëse personale për punëtorët e ndërtimtarisë (përfshirë helmetën, dorëzat, këpucët e sigurisë S3, mbrojtjen nga shiu, mbrojtjen nga zhurma, syzet mbrojtëse) duhet të sigurohen të gjitha nga punëdhënësi.
- Po ashtu edhe rrobet e punës me funksione sinjalizuese, rrobet kundër shiut si dhe rrobet e ngrohta për dimër.
- Zëvendësimi, pastrimi dhe kujdesi për pajisjet mbrojtëse dhe rrobet e punës, janë çështje e punëdhënësit.

Sigurimi dhe pastrimi i rrobeve të punës në ndërtimtari janë çështje e punëdhënësit!

Këtë mund ta bësh ti

A duhet t'i blesh vetë këpucët e sigurisë? A nuk t'i japin ty falas rrobet mbrojtëse të punës (këpucët, mbrojtjen nga shiu, etj....)? A duhet të paguash vetë për pastrimin e tyre? Nëse ti duhet të përgjigjesh me «po» vetëm në njërin nga pyetjet, atëherë lajmërohu në sekretariatën tënd të Unia. Këtu do të të tregojnë se si ti me kolegët e tu dhe me përkrahjen e Unia do të kundërvësh me sukses.



«Unë punoj në një vinç 130 metra të lartë. Punëtorët poshtë unë i shoh vetëm si thnegla. Nëse ata nuk veshin rroba mbrojtëse me ngjyra vezulluese, atëherë puna bëhet skajshmërisht e vështirë. Deri më sot ngjyrat vezulluese nuk kanë qenë të obligueshme. Kjo duhet të ndryshohet, dhe ne kështu mund të shmangim lëndimet.»

**Alex Briner, vozitës vinçi,
Affoltern a. A., Cyrih**



«Ligji është i qartë: ndërmarrja duhet t'ua paguajë punëtorëve rrobat dhe këpucët e punës. Ndërmarrja ime e bën këtë, mirëpo shumë kolegë të mi duhet ta bëjnë këtë vetë. Kjo shumë i kalon disa qindra franka në vit. Kjo është poshtërsi.»

Nelson Vieira, murator, Gjenevë



Demonstratë e madhe në Bern të shtunën, më 21 shtator 2013



Të mbrojmë pagat dhe pensionet – të ndalim mashtruesit!

- **Ndërmarrjet joserioze të ndërtimtarisë paguajnë paga të zbritura në Zvicër. Kjo i vë nën presion të gjitha pagat.**
- **Punëtorët e ndërtimtarisë punojnë shumë dhe nuk kanë marrë asnjë ngritje pagash. Në nivelet e shefave të bankave dhe të koncernëve të mëdha përkundrazi, pagat kanë eksploduar.**
- **Edhe tek Kujdesi i pleqërisë borgjezët janë duke planifikuar vjedhjen e ardhshme të pensioneve. Për këtë duhet një zbritje e AHV.**

Ne duam t'i ndalim mashtruesit, të mbrojmë pagat dhe pensionet dhe kushtet e mira e të drejta të punës për të gjithë.

Jo ditës së punës 24 orë dhe po 1:12

Më 21 shtator ne do të votojmë nëse një pjesë e shitoreve do të mund të jenë të hapura ditë e natë. Sindikatat janë duke e kundërshtuar këtë. Në mbrëmje dhe të dielën duhet të mbetet kohë për familjen dhe për miqtë.

Populli është ngopur me mashtruesit, që shërbehen në mënyrë të paskrupullt në llogari të gjithë të tjerëve. Derisa ata mjelin miliona, dallimi midis pagave bëhet gjithnjë më i madh. Me iniciativën 1:12 ne vërtetë mund t'i ndalim mashtruesit!

bau@unia.ch

UNIA

Mbrojtje më e mirë për shëndetin dhe pagat tona!

Së bashku ne duhet t'i mbrojmë pagat dhe pensionet! Së bashku ne angazhohemi për kushte më të sigurta të punës.

**Prandaj : Lajmërohu tani për demonstratën e
21 shtatorit në Bern!**


Mbiemri/Emri

Adresa/PLZ

Telefoni

E-maili

Sekcioni i Unia



A

Nicht frankieren
Ne pas affranchir
Non affrancare

Geschäftsantwortsendung Invio commerciale-risposta
Envoi commercial-réponse



Unia Zentralsekretariat

Sektor Bau
Weltpoststrasse 20
Postfach 272
3000 Bern 15